REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 742/20
Datë/Datum. 29.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT · TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI · PROCUREMENT REVIEW BODY

---

**PSH .nr. 742/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë o operatori ekonomik: NNP "STANDARD SHPK & ARIFAJ" SHPK – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i QMF-së në Veternik", me numër të prokurimit: 616-20-1234-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë, më datën: 28.10.2020, mori këtë:

# V E N D I M

**I.<u>APROVOHET</u>** , si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i QMF-së në Veternik", me numër të prokurimit: 616-20-1234-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë.

**<u>II.ANULOHET</u>**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i QMF-së në Veternik", me numër të prokurimit: 616-20-1234-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

**III**. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV** .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK - Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

**VI** .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 01.10.2020 me nr. 742/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i QMF-së në Veternik", me numër të prokurimit: 616-20-1234-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59, 60, 64, 69, 72 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 15.10.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

**Përgjigje në Pretendimi nr. 1 :** Eksperti shqyrtues sqaron se AK, përmes Letrës standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, i ka kërkuar sqarime OE ankues "AC ING SHPK & AAG PROJEKT SHPK".

Punët e Armimit nga pos. 4.1 deri tek pos.4.12, ku çmimi i armimit (furnizimi, prerja, lakimi, pastrimi dhe montimi), i ofertuar për kg është 0.40€.

Si total çmimi i juaj prej 32,896.40€, është çmim jo-normalisht i ulët në krahasim me tenderët tjerë.

Ju duhet të sqaroni në mënyrë të detajuar çmimin tuaj dhe formimin e tij për këtë pozicione, duke përfshirë dëshmitë e çmimeve nga prodhuesit apo distributorët e autorizuar, dëshmitë e prodhimit apo blerjes me çmime nga prodhuesit për llojin e mallit dhe mënyrën e realizimit të projektit me çmimin e dhënë ose favorit tuaj lidhur me furnizimet të këtyre mallrave.

Operatori ekonomik i përgjigjet AK-së, shih dëshmitë më poshtë:

SH.P.K AC.ing

AAG PROJEKT

Emri i AK: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Adresa e AK: TREPQES NR.2

Qyteti: PRISHTINË

Titulli: **"Ndertimi i QMF-se ne Veternik "**

Numri i prokurimit: **616-20-1234-5-1-1**

Numri i brendshëm: **616 20 025 511**

Nga: **"AC ing"Sh.p.k & "AAG PROJEKT" Sh.p.k** -Prishtinë

Lënda: Sqarime për pozicionet: **Punët e Armimit**

Data:**02.09.2020**

Në lidhje me kërkësen për sqarim për pozicion e armaturës nga ana juaj ne do ju ofrojmë dokumentet dëshmi për këtë pozicion.

Sqarime për pozicionet:
**Punet e Armimit nga pos.4.1 deri tek pos 4.12 ku çmimi i armaturës ( furnzimi ,prerja,lakimi,pastrimi dhe montimi) i ofertuar per kg eshte 0.40€.**
Si total çmimi i juaj prej 32.896,40 eshte çmim jo-normalisht i ulet ne krahasim me tenderuesit tjerë

Arsytimi:
Ne si konsorcium kemi ofruar çmimin 0.40 € për 1kg për arsye se jemi bazuar në çmimin e furnzimit nga furnizuesi për këtë projekt. Pasi ne kemi bërë parapagim për armature gjatë kohës së pandemisë kur çmimi ishte i favorshem në treg, pasi ka pasur ulje në berzë .

Kurse sa i përket punës se dorës ne si konsorcium e kemi llogaritur te puna e betoni,prandaj ne kemi ofruar çmimin për kg-0.40 €.

**"Tenderët Jo-normalisht të Ulët"**

"AK do të kërkoj nga OE për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen te **gjitha kushtet e mëposhtme:**
çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve** të përgjegjshëm;
çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**;
janë dorëzuar të paktën 3 **(tre) tenderë.** "

Oferta jonë nuk mundë te quhet **Jo-normalisht të Ulët sepse nuk ka asnjëren nga kto kriteter te cekura ne lartë sipas LPP.**

SH.P.K
AC.ing

AAG PROJEKT

**"Siguria e Ekzekutimit per Tenderët Jo-normalisht të Ulët"**

"AK gëzon te drejtën qe **përqindjen e kërkuar te sigurimit te ekzekutimit ta rris për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve** që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata."

Ne si konsorcium jemi te gatshëm të ju sjellim **sigurimin e ekzekutimit me vlerë më të lartë se 10% në mënyrë që tju sigurojm se do ta përfundojmë kontratën ashtu siç e lejon edhe ligji i cekur me lartë .**

Ne kemi shiquar edhe ne e-prokurim kontrata e publikuar nga KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES dhe kemi vrejtur se çmimi i armatues është afërë me çmimin tonë dhe ne mendojm se nuk e kemi çmimin jo-normalisht i ulet ne krahasim me tenderuesit tjerë .(Gjeni te bashkangjitura si deshmi kontrata ).

"AC ing"Sh.p.k

"AAG PROJEKT"Sh.p.k

BAU MARKET

BAU MARKET sh.p.k.
Tel: +383 38 602 302
E-mail: info@baumarket-rks.com
Web: www.baumarket-rks.com

Per: AC ING
Adresa: Prishtinë
Nga: BAU MARKET SHPK
Data: 02.09.2020

## NJOFTIM SQARUES

Pas kërkesës se Kompanis Ac Ing: Bau Market lëshon kete njoftim sqarues:

Kompania **AC ing shpk** që nga themelimi ka pasur bashkëpunim me **Bau Marketin** pa ndërprerë dhe për këte arsyje e kemi furnizuar me çmime të favorshme. Gjithashtu arsye tjetër është se ka bërë pages avans për armatur në kohen e pandemisë. Prandaj kur çmimi i armaturës ka pasur zbritje në tregun global ne i kemi ofruar çmimin e furnizimit për 1 kg -0,40 €.

BAU MARKET

Date: 02.09.2020

Autoriteti kontraktues e eliminon OE ankues "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK, me arsyetimin, shih dëshmitë më poshtë:

Republika e Kosovës
Komuna e Prishtinës

**Letër standarde për *tenderuesin* e eliminuar [1]**

| | |
|---|---|
| Nr. i prokurimit | 616-20-1234-5-1-1 |
| Nr i brendshëm | 616 20 025 511 |

Grup i Operatorëve Ekonomik AC ing SH.P.K.; AAG PROJEKT SH.P.K.,
**Titulli:** **„Ndertimi i QMF-se ne Veternik'**

Te nderuar
Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

*Tenderi juaj* është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyjeve në vijim:

***Tenderi i juaj*** është administrativisht e papërgjegjshme:

- ❑ Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- ❑ Nuk i keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet
- ❑ Nuk i keni plotësuar Specifikimin Teknik te dhene ne Aneksin 1
- ❑ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- ❑ Nuk e keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- ❑ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant te prokurimit;
- ❑ Gabimi(et) aritmetikor i evidentuar(a) është më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës;
- ❑ X Oferta e juaj, ne përputhje me nenin 61.4 është konsideruar si oferte abnormalisht e ulet.
- ❑ *Nëse është e zbatushme, kërkesa tjera formale/administrative.*
- ❑ **Nuk i keni përmbushur kërkesat e Kapacitetit teknik dhe profesional:**

ARSYETIM

**Tenderi juaj eshte refuzuar** për këto arsye :

Për ketë aktivitet eliminoheni pasi qe ne listën tuaj te Stafit te cilën e keni prezantuar siç vijon :

Ju jeni eliminuar sepse nuk keni dhene sqarime te argumentuara ne kërkesën tone per çmime jo –normalisht te ulta.

- Ju po ashtui ne vend te sqarimeve jeni marre me këshilla dhe interpretime ligjore qe nuk janë ne kompetencën tuaj.Per korrektësi ju sqarojmë se keresa jone eshte bazuar ne pikat 3.2 dhe 4.2 per tenderët jo normalisht te ulet ; dhe
- Keni dorëzuar nje deklarim nga nje furnitor kinse keni te parapaguara sasi te armaturës , por nuk keni dorëzuar asnjë dëshmi lidhur me kete.

Andaj duke u bazuar ne faktet e mësipërme ju nuk keni përmbushur kërkesat e Autoriteti Kontraktues te kërkuara ne dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrate andaj për ketë aktivitet do te eliminoheni.

❑ Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me Respekt!

Në nenin 4.6 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, thuhet : *Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose:*

*4.6.1 Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose*

*4.6.2 Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, ne përputhje me nenin 61 te LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim te tenderit abnormalisht te ulet", brenda dy dite nga data e vendimit.*

Gjithashtu në nenin 61 paragraf 3, thuhet: Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë.

Andaj duke pasur parasysh nenin 4.6 të Rregullat për Tender jo –Normalisht të Ulët si dhe 61 të LPP-së, mendoj se është e drejtë dhe përgjegjësi e AK-së, se pas sqarimeve të marruara në lidhje me tenderët jo normalisht të ulët të vendos që një tender ta trajtoj me tenderët tjerë.

***Përgjigje në Pretendimi nr. 2 :*** Autoriteti kontraktues përmes letrës standarde për njoftim të llogaritjes së gabuar e njofton OE të rekomanduar për dhënie të kontratës NNP"STANDARD SHPK & ARIFAJ" SHPK , Ku i thotë se si rezultat i korrigjimeve Vlera totale e ofertës, nuk është 456,220.95€, por 467,419.21, dhe e pranon se gabimet aritmetike e tejkalon korrigjimin e paraparë ligjorë +-2%, mirëpo e arsyeton se nuk do të refuzohet tenderi juaj se AK-së, kanë gabuar në paramasë dhe parallogari, shih më poshtë:

Republika e Kosovës
Komuna e Prishtinës

**Letër Standarde për njoftim të**

**Llogarijtes së gabuar**

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, TREPQES NR.2 - PRISHTINË

.. Grup i Operatorëve Ekonomik nnp Standard shpk; Arifaj.shpk

| | |
|---|---|
| Nr. i prokurimit | 616-20-1234-5-1-1 |
| Nr i brendshëm | 616 20 025 511 |

Titulli: "„Ndertimi i QMF-se ne Veternik"

Te nderuar!

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 siç citohet në vazhdim " LPP ".

Gjatë ekzaminimit të tenderit të juaj kemi gjetur gabim(e) aritmetik(e). Gabimi ose gabimet kanë të bëjnë ne pozicione, te cilat ndryshojne ne totalin e ofertes tuaj:

Gjate llogaritjes se ofertës suaj kemi vrejtur këto gabime aritmetike lidhur me këto pozicione :

Pasi qe gabimi eshte evidentuar totali i ofertës suaj ka pësuar ndryshime ,për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur ne kemi korrigjuar gabimin duke bërë amendamentet vijuese të tenderit të juaj:

**Si rezultat i korrigjimit Vlera Totale e ofertës suaj nuk eshte 456,220.95€ por eshte 467,419.21€ .**

**Ju a përkujtojmë se kjo ndryshon çmimin total te ofertës suaj dhe nese ai ndryshim eshte me shumë se (+:- 2%) tenderi juaj do te refuzohet.**

**Edhe pse ky korigjim tejkalon korigjimin e parapare ligjor (+:-2%) , tenderi juaj nuk do te refuzohet pasi qe gabimi aritmetik eshte pasojë e gabimit te Paramsës dhe Parllogarise nga Autoriteti Kontraktues.**

Nëse **nuk** pajtoheni me ketë (këto) amendament(e), ju lutem të na kontaktoni menjëherë **me shkrim** _ në adresën : **prokurimi.prishtine@rks-gov.net** ose **ne platformën elektronike me hapat si ne vijim :**

**SHENIM: Ju lutem sqarimet ti dorëzoni përmes platformës. Mos ngarkoni dokumentet tek butoni "Sqarimet e dosjes se tenderit " sepse tani jemi ne fazën e vlerësimit dhe ai buton tashme është mbyllur. Butoni "Sqarimet e dosjes se tenderit' përdoret gjate fazës**

Eksperti shqyrtues konstaton se në pikën 3 të nenit 59 të LPP-së, thuhet: “Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve, sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës”.

Në nenin 41.8 të RRUOPP-së, thuhet: “AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës”.

*i. Ne rast se shuma e korrigjuar është me pak se +/- 2%, AK do te përmirësoj gabimet e tilla dhe do te informoj me shkrim OE ne fjale duke përdorur formën standarde B49. Ne rast se OE ne fjale nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta ne fjale do te refuzohet. AK gjithashtu duhet ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE te cilët kane dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.*

*ii. Ne rast se shuma e korrigjuar është me shume se +/- 2%, AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B42.*

Andaj bazuar në nenin 59 paragraf 3 të LPP-së, si dhe në pikën (ii) të nenin 41.8 të RRUOPP-së, AK-së është dashur të eliminoj OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

**Përgjigje në Pretendimi nr. 3:** Eksperti shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkua “Inxhinier i diplomuar i makinerisë (dega Termoenergjetik Termoteknikë) min. 5 vite përvoje pune pas diplomimit”.

Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ankues NNP “STANDARD SHPK & ARIFAJ” SHPK, në dosjen e tenderit i kanë ofruar zotërinjtë Rasim Mjekiqi, Muhamet Xhylani dhe Edmir Qerkezi, të cilët janë Inxhinier të Makinërisë, mirëpo në Diplomën e asnjërit nuk figuron (dega Termoenergjetik Termoteknikë), shihe dëshmitë.


REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

Nr. 3142

DIPLOME

Nr. 3142

Studenti EDMIR HAMIT QERKEZI
filloi studimet në vitin 2001
dhe mbaroi në vitin 2006
kursin e plotë të Fakultetit TE INXHINIERISE MEKANIKE
Të Universitetit Politeknik Tiranë
në degën MEKANIKE
Me vendim të komisionit shtetëror
dt. 13-07-2006
I jepet titulli INXHINIER MEKANIK
PROFILI IZ...

REKTORI I UNIVERSITETIT

United Nations Interim Administration Mission in Kosovo

Universiteti i Prishtinës
*University of Prishtina*

FACULTY OF MECHANICAL ENGINEERING

## DIPLOMA

IN UNIVERSITY EDUCATION

**MUHAMET BAJRAM XHYLANI**

BORN IN BAICË-GLLOGOVC ON 17 FEBRUARY 1980

REGISTERED IN THE ACADEMIC YEAR 1998/99

COMPLETED ALL THE REQUIRED EXAMINATIONS

AT THE FACULTY OF MECHANICAL ENGINEERING

SECTION OF TRANSPORT AND TRAFFIC

ON 28 DECEMBER 2006 AND OBTAINED

THE UNIVERSITY TITLE

GRADUATE MECHANICAL ENGINEER

Average grade of studies 6.74

Diploma examination grade 9.00

FAKULTETI I INXHINERISË MEKANIKE

# DIPLOMË

E KUALIFIKIMIT UNIVERSITAR

**MUHAMET BAJRAM XHYLANI**

LINDUR NË BAICË-GLLOGOVC MË **17 SHKURT 1980**

REGJISTRUAR NË VITIN AKADEMIK **1998/99**

**MË 28. 12. 2006** I KA DHËNË PROVIMET E PARAPARA

PËR TË MBARUAR FAKULTETIN E MAKINERISË

**DREJTIMI I KOMUNIKACIONIT**

DHE ME KËTË MERR KUALIFIKIMIN

**INXHINIER I DIPLOMUAR I MAKINERISË**

Nota mesatare gjatë studimeve **6.74**

Nota e provimit të diplomës **9.00**

PRISHTINË, MË **28 SHKURT 2007**, NR. **256**

Dekani
Prof. Dr. Ismajl Gojani

Rektori
Prof. asc. Enver Hasani

SOCIJALISTIČKA FEDERATIVNA REPUBLIKA JUGOSLAVIJA

SOCIJALISTIČKA REPUBLIKA HRVATSKA

SVEUČILIŠTE U ZAGREBU

FAKULTET STROJARSTVA I BRODOGRADNJE U ZAGREBU

# DIPLOMA

O STEČENOJ VISOKOJ STRUČNOJ SPREMI

## RASIM MJEKIQI

rođen 28. lipnja 1957. u [illegible], Socijalistička Republika [illegible] [illegible] Kosovo, završio je dana 30. svibnja 1980. na ovom fakultetu studij

STROJARSTVA

u trajanju od deset semestara.

Fakultet strojarstva i brodogradnje u Zagrebu utvrđuje da je

RASIM MJEKIQI

udovoljio svim propisima za stjecanje visoke stručne spreme, postigao visoku stručnu spremu i stekao stručni naziv

DIPLOMIRANI INŽENJER STROJARSTVA

kao i sva prava koja mu pripadaju po propisima.

U Zagrebu, 30. svibnja 1980.

Broj: 4239/15 – 969

Dekan
Dr [illegible]

pdfelement

pdfelement

**Përgjigje në Pretendimi nr. 4 :** Operatori ekonomik ankues "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK, pretendon se për teknikët e ndërtimtarisë ka bashkangjitur një Diplomë të shkollës së mesme dhe një Certifikatë, ku Maksut Tacolli ka titullin teknik Topogaf dhe Fiqiri Tahiri ka titullin minator.

Eksperti shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit janë kërkuar "Teknike te ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit".

OE i rekomanduar për dhënie të kontratës në dosjen e tenderit e ka ofruar Certifikatën dhe Diplomën të cilat i ka i ka cekur OE ankues, për më tepër shih dëshmitë më poshtë.



MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE DHE TURIZMIT
Komisioni i Dhënies së Liçensave Profesionale

LIÇENSE
TZ.0378

| | |
|---|---|
| MBIEMRI | TOCILLA |
| EMRI | MAKSUT |
| ATESIA | XHEMAL |
| DATELINDJA | 22.09.1960, Kukes |
| VENDBANIMI | KUKES |
| DIPLLOMUAR, ME | 1979 |
| TITULLI | Teknik Topograf |
| Rregjistruar ne Rregjistrin themeltar qe nga data: | 17.06.2002 |

NE ZBATIM

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kat. | 1 | | Germime dheu me punime eventuale murature e beton arme – Prishje dhe punime ne toke te germuar. |
| Kat. | 2 | a | Prodhim materiale inerte – gure |
| Kat. | 14 | b | Pastrimi i siperfaqes urbane. |
| | | c | Kryerja e punimeve ne sherbesat funerale. |
| Kat. | 15 | a | Rivelime topografike. |
| | | b | Punime topogjeodezike ne objekte inxhinierike. |

KRYETARI I KOMISIONIT

Agron DIBRA

REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTË E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

Seksioni i Arsimit dhe i Kulturës i rrethit të Kukësit

Shkolla e mesme profesionale "Muhamet Mula"

Nr. i amzës 690 Nr. i regjistrit të veçantë 561

# DËFTESË PJEKURIE



Fiqiri Bajram Taliti lindur më 01.8.1970
(emri) (atësia) (mbiemri)

në Kalimash të rrethit të Kukësit

në vitin shkollor 1987 1988 ka kryer shkollën e mesme profesionale

me shkëputje nga puna në specialitetin minierë

Në përfundim të mësimeve ka marrë këto nota:

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. Njohuri të marksizëm-leninizmit | 5 (pesë) | 14. Shfrytëzim V.B | 6 (gjashtë) |
| 2. Letërsi | 7 (shtatë) | 15. Makina - Transport | 6 (gjashtë) |
| 3. Gjuhë e huaj | 6 (gjashtë) | 16. Teknikë - Sigurimi | 7 (shtatë) |
| 4. Matematikë | 6 (gjashtë) | 17. Edukim fizik | 6 (gjashtë) |
| 5. Fizikë | 6 (gjashtë) | 18. Edukim Ushtarak | 7 (shtatë) |
| 6. Kimi | 6 (gjashtë) | 19. Pun. prodhuese-prakt. profes. | 10 (dhjetë) |
| 7. Vizatim Teknik | 6 (gjashtë) | 20. | |
| 8. Mekanikë Teknike | 5 (pesë) | 21. | |
| 9. Baza gjeollogjie | 6 (gjashtë) | 22. | |
| 10. Mark. shpërthim | 7 (shtatë) | 23. | |
| 11. Elektroteknikë | 8 (tetë) | 24. | |
| 12. Organizim - Planifikim | 7 (shtatë) | 25. | |
| 13. Ndërtim punimesh | 6 (gjashtë) | 26. | |

Në provimet e pjekurisë të sesionit parë të vitit shkollor 1987 1988 mori këto nota:
mbrojtjen e diplomës

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. Njohuri të marksiz-leniniz. | 5 (pesë) | 4. Makina - Transport | 6 (gjashtë) |
| 2. Matematikë | 6 (gjashtë) | 5. | |
| 3. Ndërtim punimesh | 8 (tetë) | | |

Në provimin e atestimit mbrojti shkallën ulët të kualifikimit, kategorinë II-të ( dytë ) në profesionet bazë të profilit: ndihmës minator + armator

Shënime mbi formimin e gjithanshëm dhe sjelljen: Nxënës me sjellje shumë të mirë, përgatitje mesatare, i dashur me shokët, dallohet në aktivitetet jashtëshkollore, ka mundësi për rezultate më të mira

Duke marrë parasysh përfundimet vjetore dhe të pjekurisë, i njihet nxënësit Fiqiri Taliti mbarimi i shkollës së mesme

Kukës më 4.7 1988

Drejtori i shkollës
( Ardi Kovaçi )

Shënim. Nota më e ulët kaluese është pesa.

***Përgjigje në Pretendimi nr. 5 :*** Operatori ekonomik ankues "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK, pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ngarkuar Licencë të vlefshme nga Agjensioni për miniera dhe minerale dhe nuk i ka ngarkuar pajisjet për furnizim me beton siç kërkohet në Aneksin 7 të pajisjet

Eksperti shqyrtues sqaron se tek njoftimi për kontratë dhe dosje të tenderit konkretisht te dëshmitë dokumentare është kërkuar: "*Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale*", dhe tek dëshmitë dokumentare është kërkuar: *"Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale. Në rastet kur O.E. ka marrëveshje për furnizim, O.E. duhet të dorëzoj edhe kopjen e marrëveshjes për furnizim"*.

Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës NNP "STANDARD SHPK & ARIFAJ" SHPK, nuk ka ofruar dëshmi për kërkesën "*Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale*". Mirëpo pas kërkesës së AK-së, për sqarime shtesë, OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar Marrëveshje në mes të NNP "STANDARD" SHPK& TITAN BETON" L.L.C, si dhe kopjen e Licencës të kërkua, për më tepër shih dëshmitë më poshtë:

MARRËVESHJE PËR FURNIZIM ME BETON DHE SHFRYTËZIM TË MAKINERISË

Lenda: *Marrëveshje për Furnizim me Beton dhe Shfrytëzim të Makinerisë*

Partnerët:

1. "Titan Beton L.L.C me NRF : 810541715 themeluar në Prishtinë, përfaqësuar nga Guxim Bytyqi Drejtor

2. Standard shpk me NIF: 810448507 themeluar në Prishtinë, përfaqësuar nga Vehbi Zariqi Drejtor

Lënda: *Marrëveshje për Furnizim me Beton dhe Shfrytëzim të Makinerisë*

Të cilët më tutje do të quhen si **bashkëpunëtorët**, kanë arritur marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1

Palët njëzëshëm u pajtuan për Furnizim me Beton nga kompania Titan Beton si dhe dhënja në shfrytëzimin e Makinerisë për Standard shpk

**Marrëveshja është në bazë vjetore për vitin kalendarik 2020-2022**

Neni 2

Furnizuesi është pronar I Fabrikës së Betonit si dhe I Makinersë.

Neni 3

Palët u pajtuan që çmimet të caktohen me aneks të veçantë për secilën punë veç e veç.

Neni 4

Palët u pajtuan që bleresi duhet të parashtroje kerkesen për furnizim në shfrytëzim së paku 7 ditë para kohës që i nevojitet.

Neni 5

Palët u pajtuan që pagesat të behen sipas marreveshjeve të veçanta pas kërkesës së porositësit .

Neni 6

Marrëveshja hyn në fuqi me rastin e nenshkrimit te marrëveshjes nga të dyja palet.

**Palët e marrëveshjes:**

1. "Titan Beton L.L.C"
   Z. Guxim Bytyqi

2. Standard shpk
   Z. Vehbi Zariqi

Prishtinë, 29.05.2020



pdfelement



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale

Independent Commission for Mines and Minerals

*LEJE PËR AKTIVITETET E VEÇANTA*

*DOZVOLE ZA POSEBNE AKTIVNOSTI / SPECIAL OPERATIONS PERMIT*

633/KPMM/2018

| | |
|---|---|
| Emri i Biznesit / Naziv Biznisa / Name of Business: | "Ujmi Beton L.L.C." sh.p.k. |
| Nr. i Biznesit / Br.Biznisa / Business No: | [illegible] |
| Nr. i Regjistrit / Br.Registracije / Registration No: | 927 |
| Pronar i Biznesit / Vlasnik Biznisa / Business Owner: | [illegible] |
| Kohëzgjatja / Trajanje / Duration: [illegible] | Sipërfaqja / Površina / Surface area: [illegible] |
| Emri i vendit / Ime mesta / Site name: [illegible] | Leje për / Dozvola za / Permit for: |
| Komuna / Opština / Municipality: [illegible] | *baza e betonit / osnova za beton / concrete base* |

Të drejtat dhe detyrimet / Prava i obaveze / Rights and obligations:

**Përgjigje në Pretendimi nr. 6 :** Operatori ekonomik ankues "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK, pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ngarkuar Licencë të vlefshme nga Agjensioni për miniera dhe minerale dhe nuk i ka ngarkuar pajisjet për furnizim me beton siç kërkohet në Aneksin 7 të pajisjet

Eksperti shqyrtues sqaron se tek njoftimi për kontratë dhe dosje të tenderit konkretisht te dëshmitë dokumentare është kërkuar: "Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT", dhe tek dëshmitë dokumentare është kërkuar: "OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e pasjeve duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes se Tenderit dhe duhet te bashkëngjis Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet te dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim".

Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës NNP “STANDARD SHPK & ARIFAJ” SHPK, pas kërkesës së AK-së, për sqarime shtesë, përveç Marrëveshje në mes të NNP “STANDARD” SHPK & TITAN BETON” L.L.C, kopjes së Licencës, i ka ofruar edhe Librezat e pajisjeve, për më tepër shih dëshmitë më poshtë:



pdfelement



13-01-2016

01-02-2019

11.02.2021

REPUBLIKA E KOSOVËS

РЕПУБЛИКА КОСОВО

REPUBLIC OF KOSOVO

RKS

CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT TË AUTOMJETIT

УВЕРЕЊЕ РЕГИСТРАЦИЈЕ ВОЗИЛА

VEHICLE REGISTRATION CERTIFICATE

CRA/YPB/VRC 0715289

| | | |
|---|---|---|
| A | | |
| I | | |
| C | | |
| C.2 | | |
| C.2.1 | | |
| C.2.2 | | |
| C.2.3 | | |
| D | | |
| C | | |
| D.1 | | |
| D.2 | | |

| | | |
|---|---|---|
| D.3 | | ACTROS 4144 |
| E | | WDB9321611L392159 |
| S | | 2007 |
| B | | |
| S.1 | | 2 |
| S.2 | | |
| O | | |
| F | | |
| F.1 | | |
| G | | 49732 |
| K | | |

| | | |
|---|---|---|
| P | | |
| P.1 | | 12.000 |
| P.2 | | 400 |
| P.3 | | Diesel |
| R | | E Dakëtë / E Kaltër |
| 2A | | Automjet Bartës i Dyt... |

18-12-2020

RA/YPB/VRC 108...

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO

**RKS**

CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT TË AUTOMJETIT
UVERENJE REGISTRACIJE VOZILA
VEHICLE REGISTRATION CERTIFICATE

01-348-JC

RA/YPB/VRC 1084835

08-09-2020

CRA/YPB/VRC

CRA/YPB/VRC 0883879

REPUBLIKA E KOSOVËS
РЕПУБЛИКА КОСОВО
REPUBLIC OF KOSOVO

RKS

CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT AUTOMJETIT
УВЕРЕЊЕ РЕГИСТРАЦИЈЕ ВОЗИЛА
VEHICLE REGISTRATION CERTIFICATE

CRA/YPB/VRC

pdfelement



A 01-836-FB
I 03-06-2015
C.2.1 „Titan Beton L.L.C" SH.P.K.
C.2.3 Magjistralja Pr-Mitrovice PRISHTINE PRISHTINE
B 22-02-1990
D.1 Volvo
D.3 FI 108441
E YV2F2E3D3LA343307
1990
S.1 2
F 26000
F.1 14510
G 11490
P.1 9600
P.3 Dizel
R E Bardhe
2A Kamion Mikser 2 Dyer



03-06-2016
21-06-2017
27-06-2018
26-06-2020
RKS
01-836-FB
CRA/VPB/VRC 0644727

Eksperti shqyrtues sqaron se në paragrafin 2 të nenit 59 të LPP-së, thuhet: *"Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues". Andaj bazuar në paragrafin 2 të nenit 59 të LPP-së, mendoj se me dëshmitë e ofruara pas sqarimeve shtesë, për dokumente e kërkuara të cilat nuk janë në dosjen e tenderit, mendoj se kemi të bëjmë me ndryshim materia.*

**Mendimi i ekspertit shqyrtues**: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe lënda të kthehet në **rivlerësim**.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 19.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Nuk Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues. Përgjigje lidhur me ekspertizën numër lidhur me aktivitetin e prokurimit : Ndërtimi i QMF-së ne Veternik.

Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar me kujdes te gjitha përgjigjet tuaja ne pretendimet e ankuesit dhe konstaton se asnjëra nga ato nuk është ne harmoni me dispozitat ligjore dhe e bazuar ne kërkesat e FDT-së për ketë aktivitet.

Arsyetimet lidhur me ketë i paraqesim ne vijim:

- Lidhur me përgjigjen e pare pretendimet se ne nuk kemi pasur te drejt te kërkojmë sqarime shtese për çmime jonormalisht te ulta, ju kisha preferuar te lexoni me kujdes Rregullat për tenderët jonnormalisht te ultë, ndërsa ajo qe ka te bëjmë konstatimin tuaj se pas pranimit te sqarimeve tenderi i tenderuesit qe i janë kërkuar sqarime duhet te trajtohet sikurse tenderët e tjerë iu sugjeroj te lexoni pikat 4.6.1 ku përcaktohet çart se nëse janë dhëne sqarim ete mjaftueshme tenderi do te trajtohet si tender tjetër te përgjegjshëm dhe piken vijuese 4.6.2 ku përcaktohet si vijon-nëse sqarimi nuk mjafton te refuzoj tenderin . Po ashtu lidhur me përgjigjen tuaj sipas te cilës ankuesi ka dhënë sqarime te mjaftueshme ju sqarojmë se deklarata e një OE-ik tjetër se ka pagesa ne avans, pa asnjë dëshmi pagese lidhur me këtë nuk mund te jete e pranueshme ne asnjë rast. Po ashtu as pajtimi për rritjen e sigurisë se ekzekutimit nuk paraqet asnjë siguri te realizimit te projektit me çmime e dhëne. Lidhur me ketë ua përkujtoj se për një aktivitet tjetër Paneli i OSHP-së na ka rekomanduar mendoj plotësisht me te drejt se pranimi i dëshmive te tilla ne forme te deklarimeve dhe rritja e përqindjes se sigurimit te ekzekutimit nuk i sigurojnë Autoritetit Kontraktues realizimin e suksesshëm te projektit.
- Lidhur me përgjigjen tuaj për sqarimet lidhur me tejkalimin e gabimit aritmetik është e sqaruar ne raportin e vlerësimit se ai gabim nuk është bere me fajin e tenderueseve, por ka qen gabim i kodimit te paramases dhe parallogarit nga ana e njësisë se kërkesës dhe do te duhej te sqaroni a do te ishte veprim i drejt qe Autoriteti Kontraktues te refuzonte tenderët e njembedhjet tenderuesve pa fajin e tyre dhe njëkohësisht a dot e ishte e drejt te refuzojnë tenderët e tenderueseve tjerë qe nuk kanë korrigjim te çmimit me arsyetimin se kanë ndërhyre ne paramase dhe parallogari;
- Lidhur me përgjigjen numër tre e pranojmë se ne diplomë e asnjërit nga inxhinieret e përmendur nuk figuron drejtimi i cekur, por inxhinieri Rasim Mjekiqi ka diplomuar ne vitin 1980 dhe sigurisht ne atë kohe nuk ka ekzistuar kjo ndarje e drejtimeve te cekura ne kërkesat tona dhe për këtë arsye është trajtuar sie pranueshme;
- Lidhur me përgatitjen shkollore te teknikeve te ndërtimit ju sqarojmë se tenderuesi i propozuar për dhënie te kontratës ka dorëzuar dëshmi për dy teknik me profesionet qe keni cekur, por janë

trajtuar site pranueshme pasi qe ne FDT nuk është cekur qartë se cfare drejtimesh duhet te kenë tekniket e kërkuar, por te jen Teknik te ndërtimtarisë dhe te kenë dy vite përvoje pune.

Nëse eksperti do te analizonte sadopak deshmit e parashtruesit te ankese do te vërente lehtë se edhe i njëjti ne ketë pik është i pa përgjegjshëm, pasi qe ka ofruar ne liste vetëm një Teknik te ndertimitarise dhe po ashtu ka dëshmi vetëm për te njëjtën e jo për te dy Teknik si qe është kërkuar ne FDT-ne e dosjes se tenderit.

Bazuar ne konstatimet e paraqitura lidhur me përgjigjet e ekspertit kërkojmë qe përgjigjet e te njëjtit te hudhen poshtë nga Paneli Shqyrtues dhe i njëjti te aprovoj propozimin tone për dhënie te kontratës.

Operatori Ekonomik, me datë: 16.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Nuk Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Përgjigje nga OE

Pasi kemi pranuar email me datë :15.10.2020, ora 1:04 nga OSHP-ja ku ne email është bashkangjitur raporti i ekspertit me numër 742-20 dhe është kërkuar te japim një përgjigje për këtë raport se pajtohemi apo nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit.

Ne nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit për arsye se ka dëshmi te mjaftueshme qe eksperti te propozon te paneli shqyrtues i OSHP-së ne si GOE si plotësojmë kushtet baze te njoftimit për kontratë dhe ne baze te FDT-së

Prandaj kërkojmë nga paneli shqyrtuese i OSHP-së te merr vendim te qartë ku ne te shpallemi fitues si GOE me çmim me te ulet dhe ta hudh poshtë propozimin e ekspertit për rivlerësim.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron se AK i ka kërkuar sqarime për çmime jo normalisht të ulëta OE ankues "AC ING SHPK & AAG PROJEKT SHPK", më saktësisht për Punët e Armimit nga poz. 4.1 deri tek poz. 4.12, ku çmimi i armimit (furnizimi, prerja, lakimi, pastrimi dhe montimi), i ofertuar për kg është 0.40€. Si total çmimi i juaj prej 32,896.40€, është çmim jo-normalisht i ulët në krahasim me tenderët tjerë. Ju duhet të sqaroni në mënyrë të detajuar çmimin tuaj dhe formimin e tij për këtë pozicione, duke përfshirë dëshmitë e çmimeve nga prodhuesit apo distributorët e autorizuar, dëshmitë e prodhimit apo blerjes me çmime nga prodhuesit për llojin e mallit dhe mënyrën e realizimit të projektit me çmimin e dhënë ose favorit tuaj lidhur me furnizimet të këtyre mallrave.

Operatori ekonomik i është përgjigjur AK-së me dëshmitë se: "Ne si konzorcium kemi ofruar çmimin 0. 40 për 1 kg për arsye se jemi bazuar ne çmimin e furnizimit nga furnizuesi për këtë projekt. Ne kemi bërë parapagimin për armaturë në kohen e pandemisë ku çmimi ishte me i favorshëm në treg dhe ka pasur ulje në berzë". Me tej OE ka përshkruar arsyet se si konsiderohet një çmim jo normalisht i ulët dhe ka cekuar se oferta e tyre nuk ka plotësuar kushtet për tu cilësuar si e tillë.

Operatori ekonomik po ashtu ka bashkangjitur edhe një dëshmi se është i gatshëm të sjellë sigurinë e ekzekutimit në vlerë më të lartë si 10% si dëshmi se mund të realizojnë kontratën ashtu siç e lejon ligji. Për më tepër OE ankues ka bashkangjitur edhe një njoftim sqarues të kompanisë AC ing shpk ku thuhet se: "Bau market ka bashkëpunim me kompaninë në fjalë e cila furnizohet që nga fillimi nga ata dhe e kanë furnizuar me çmime më të favorshme. Gjithashtu sipas tyre kompania ka bërë pagesë avans gjatë kohës së pandemisë për armaturë dhe duke pasur parasysh që gjatë pandemisë çmimi ka rënë në tregun global, ne i kemi ofruar çmimin prej 0. 40 për 1 kg"

Autoriteti kontraktues e eliminon OE ankues "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK, me arsyetimin: "Ju jeni eliminuar për shkak se nuk keni dhënë sqarime të argumentuara në kërkesën tonë për çmime jo normalisht të ulëta. Në vend të sqarimeve jeni marrë me këshilla dhe interpretime ligjore që nuk janë kompetencë e juaja dhe keni dorëzuar një deklarim nga një furnitor kinse keni të parapaguara sasi të armaturës, por nuk keni dorëzuar asnjë dëshmi lidhur me këtë"

Paneli shqyrtues sqaron se në nenin 4.6 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, thuhet : *Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose:*

*4.6.1 Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose*

*4.6.2 Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, ne përputhje me nenin 61 te LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim te tenderit abnormalisht te ulet", brenda dy dite nga data e vendimit.*

Gjithashtu në nenin 61 paragraf 3, thuhet: Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë.
Andaj duke u bazuar nenin 4.6 të Rregullat për Tender jo –Normalisht të Ulët si dhe 61 të LPP-së, paneli shqyrtues vlerëson se është e drejtë dhe përgjegjësi e AK-së, se pas sqarimeve të marruara në lidhje me tenderët jo normalisht të ulët të vendos që një tender ta trajtoj me tenderët tjerë, mirëpo se pari per tu trajtuar një tender me çmime abnormalisht te ulëta duhet te plotësohen tre kushtet e rregullave te KRPP-se, e ne rastin konkret AK nuk e ka sqaruar se a plotësohen apo jo prandaj ky pretendim ankimor është i bazuar dhe AK pa te drejte e ka eliminuar operatorin ankues per këtë çështje.

Autoriteti kontraktues përmes letrës standarde për njoftim të llogaritjes së gabuar e njofton OE të rekomanduar për dhënie të kontratës NNP"STANDARD SHPK & ARIFAJ" SHPK , duke i thënë se si rezultat i korrigjimeve Vlera totale e ofertës, nuk është 456,220.95€, por 467,419.21, dhe e pranon se gabimet aritmetike e tejkalon korrigjimin e paraparë ligjorë +-2%, mirëpo e arsyeton se nuk do të refuzohet tenderi juaj se AK, kanë gabuar në paramasë dhe parallogarit. Paneli shqyrtues konstaton se në pikën 3 të nenit 59 të LPP-së, thuhet: "Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve, sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës".
Në nenin 41.8 të RRUOPP-së, thuhet: "AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përçin (2%) i vlerës totale të ofertës".
*i. Ne rast se shuma e korrigjuar është me pak se +/- 2%, AK do te përmirësoj gabimet e tilla dhe do te informoj me shkrim OE ne fjale duke përdorur formën standarde B49. Ne rast se OE ne fjale nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta ne fjale do te refuzohet. AK gjithashtu duhet ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE te cilët kane dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.*
*ii. Ne rast se shuma e korrigjuar është me shume se +/- 2%, AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B42.*

Andaj bazuar në nenin 59 paragraf 3 të LPP-së, si dhe në pikën (ii) të nenin 41.8 të RRUOPP-së, paneli shqyrtues konstaton se AK është dashur të eliminoj OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues konstaton se në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit është kërkuar "Inxhinier i diplomuar i makinerisë (dega Termoenergjetik Termoteknikë) min. 5 vite përvoje pune pas diplomimit". Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ankues NNP "STANDARD SHPK & ARIFAJ" SHPK, në dosjen e tenderit i kanë ofruar Rasim Mjekiqi, Muhamet Xhylani dhe Edmir Qerkezi, të cilët janë Inxhinier të Makinerisë, mirëpo në Diplomën e asnjërit nuk figuron (dega Termoenergjetik Termoteknikë), shihe dëshmitë, andaj paneli shqyrtues vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit.

Operatori ekonomik ankues "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK, pretendon se për teknikët e ndërtimtarisë ka bashkangjitur një Diplomë të shkollës së mesme dhe një Certifikatë, ku Maksut Tacolli ka titullin teknik Topogaf dhe Fiqiri Tahiri ka titullin minator. Paneli shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit janë kërkuar "Teknike te ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit". OE i rekomanduar për dhënie të kontratës në dosjen e tenderit e ka ofruar Certifikatën dhe Diplomën të cilat i ka i ka cekur OE ankues, andaj paneli shqyrtues e vlerëson si të qëndrueshëm pretendimin e OE ankues.

Operatori ekonomik ankues "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK, pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ngarkuar Licencë të vlefshme nga Agjensioni për miniera dhe minerale dhe nuk i ka ngarkuar pajisjet për furnizim me beton siç kërkohet në Aneksin 7 të pajisjet. Paneli shqyrtues sqaron se tek njoftimi për kontratë dhe dosje të tenderit konkretisht te dëshmitë dokumentare është kërkuar: "*Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale*", dhe tek dëshmitë dokumentare është kërkuar: *"Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale. Në rastet kur OE ka marrëveshje për furnizim, OE duhet të dorëzoj edhe kopjen e marrëveshjes për furnizim"*.
Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës NNP "STANDARD SHPK & ARIFAJ" SHPK, nuk ka ofruar dëshmi për kërkesën "*Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale*". Mirëpo pas kërkesës së AK-së, për sqarime shtesë, OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar Marrëveshje në mes të NNP "STANDARD" SHPK& TITAN BETON" L.L.C, si dhe kopjen e Licencës të kërkuar.

Operatori ekonomik ankues "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK, pretendon se OE i

rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ngarkuar Licencë të vlefshme nga Agjensioni për miniera dhe minerale dhe nuk i ka ngarkuar pajisjet për furnizim me beton siç kërkohet në Aneksin 7 të pajisjet. Paneli shqyrtues sqaron se tek njoftimi për kontratë dhe dosje të tenderit konkretisht te dëshmitë dokumentare është kërkuar: "Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT", dhe tek dëshmitë dokumentare është kërkuar: "OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e pasjeve duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes se Tenderit dhe duhet te bashkëngjis Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet te dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim".

Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës NNP "STANDARD SHPK & ARIFAJ" SHPK, pas kërkesës së AK-së, për sqarime shtesë, përveç Marrëveshje në mes të NNP "STANDARD" SHPK & TITAN BETON" L.L.C, kopjes së Licencës, i ka ofruar edhe Librezat e pajisjeve.

Paneli shqyrtues sqaron se në paragrafin 2 të nenit 59 të LPP-së, thuhet: *"Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues". Andaj bazuar në paragrafin 2 të nenit 59 të LPP-së, paneli shqyrtues konsideron se me dëshmitë e ofruara pas sqarimeve shtesë, për dokumente e kërkuara të cilat nuk janë në dosjen e tenderit, mendoj se kemi të bëjmë me ndryshim material andaj pretendimet ankimore janë të qëndrueshme.*

Paneli shqyrtues vlerëson se gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit AK nuk ka vepruar sipas dispozitave të LPP-së më saktësisht nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform dispozitave të nenit 59 të LPP-së.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, pasi qe ka shpalle fitues OE të pa përgjegjshëm sepse nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te publikuara ne njoftimin për kontrate dhe ne dosje te tenderit.

Paneli shqyrtues vlerëson se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 dhe 60 të LPP-së.

Po ashtu, autoriteti kontraktues duhet të këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK - "Kuvendi Komunal Prishtinë"

1x1 OE - "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK- Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.